

Udhëtimi me mjete të transportit publik në Zvicër: Për cilin abonim/cilën biletë kam nevojë?

A udhëtoni ju...

abonim ideal/bileta ideale

gjithmonë të njëjtën rrugë (që nga rreth 121 km)?	General-Abo (abonim i përgjithshëm për udhëtim të lirë në rrjetin e transportit publik)
shpesh herë rrugë të gjata, të ndryshme?	Abonim i përgjithshëm (për kuptimin shih lart)
gjithmonë të njëjtën rrugë (deri në rreth 121 km)?	Strecken-Abo (abonim rruge për udhëtim të lirë në rrugë të caktuara)
vetëm me mjete të transportit urban?	Verbund-Abo (abonim për udhëtim të lirë në një lidhje të qarkullimit) (p.sh. Libero-Abo (abonim Libero))
midis dy lidhjeve të qarkullimit	Inter-Abo (abonim për udhëtime me tren dhe mjete të transportit të afërt)
nganjëherë rrugë të ndryshme?	Halbtax-Abo (abonim për udhëtime në rrjetin e transportit publik për gjysmën e çmimit)
herë pas here një ditë të tërë?	Halbtax-Abo (për kuptimin shih lart) dhe bileta ditore (udhëtim i lirë në rrjetin e transportit publik gjatë një dite të plotë)

A keni ...

Abonim ideal/biletë ideale

një familje që udhëton shumë?	GA-Plus Familia (abonim i përgjithshëm për të gjithë familjen)
fëmijë nga 6 deri 16 vjeç:	Junior-Karte (fëmijë në moshën 6-16 vjeç udhëtojnë falas në rrjetin e transportit publik, kur shoqërohen nga një prind)
fëmijë nga 16 deri 25 vjeç?	Halbtax-Abo (për kuptimin shih lart) dhe Gleis7 (udhëtim i lirë që nga ora 19.00 në rrjetin e transportit publik për posedues të abonimit 'Halbtax' nën 25 vjeç)

nipa dhe mbesa nga 6 deri 16 vjeç?	Enkel-Karte (fëmijë në moshën 6-16 vjeç udhëtojnë falas në rrjetin e transportit publik, kur shoqërohen nga një gjysh ose gjyshe)
një qen?	Hunde-GA (abonim i përgjithshëm për qen) ose Hunde-Tageskarte (biletë ditore për qen) (qen të vegjël deri në 30 cm lartësi të supit dhe qen për përdorim, p.sh. qen për udhëheqjen e të verbërve, udhëtojnë falas)
bashkë me biçikletën?	Velo-Pass (1-pasaportë vjetore për transportimin e biçikletës me mjete të transportit publik), Velo-Tageskarte (biletë ditore për transportimin e biçikletës me mjete të transportit publik), Velo-Multitageskarte (kartë për transportimin e gjashtëfishtë të biçikletës me mjete të transportit publik)
A jeni ju ...	Abonim ideal/biletë ideale
një grua që nga 64 vjeç respektivisht një burrë që nga 65 vjeç?	GA-Senior (abonim i përgjithshëm për femra që nga ditëlindja e 64-t dhe meshkuj që nga ditëlindja e 65-të)

Udhëtarë me lëvizshmëri të kufizuar: “SBB” synon që t’u mundësojë, hap pas hapi, të gjithë udhëtarëve akses autonom. Atje ku kjo ende nuk është e mundshme, ofrohen zgjidhje zëvendësuese (ndihmë gjatë hipjes dhe zbritjes). Për rezervimin e ndihmës për hipjen dhe zbritjen dhe informacione të tjera (kohët e shërbimit, ulje çmimi për udhëtimet etj.) është në dispozicionin tuaj 'Call Center Handicap' nën numrin falas 0800 007 102. Në stacionet ndihma taktile e lehtësojnë orientimin dhe ekrane si dhe përforcues të dëgjimit komunikimin.

Blerja: Abonimet dhe biletat e lartpërmendura mund të blihen në stacionin e trenit. Por ju mund t’i porosisni gjithashtu në internet www.sbb.ch/ticketshop. Informacione të mëtejshme merrni në çdo sportel të hekurudhës.

Udhëtimi me mjete të transportit publik në Bernë: Për cilën abo/biletë kam nevojë?

A udhëtoni ju ...

Abonim ideal/biletë ideale

në mënyrë të parregullt rrugë të shkurtra?	Kurzstreckebillett einzel (biletë për një udhëtim të vetme në distancë të shkurtër) ose Mehrfahrtenkarte (biletë për disa udhëtime në distancë të shkurtër)
në mënyrë të parregullt rrugë të gjata?	Einzelbillett nach Zonen (biletë për një udhëtim të vetme në një ose disa zona) ose Mehrfahrtenkarte (biletë për disa udhëtime në një ose disa zona)
herë pas here një ditë të tërë?	Tageskarte (për kuptimin shih lart)
rregullisht rrugë të shkurta dhe të gjata?	Libero-Abo (abonim Libero)

A keni ...

Abonim ideal/biletë ideale

fëmijë nga 6 - 16 vjeç?	Junior-Karte (për kuptimin shih lart) është e vlefshme
nipa dhe mbesa nga 6 - 16 vjeç?	Enkel-Karte (për kuptimin shih lart) është e vlefshme
një qen?	Tarifa e reduktuar për klasën e 2-të (qen të vegjël deri në 30 cm lartësi të supit dhe qen për përdorim, p.sh. qen për udhëheqjen e të verbërve udhëtojnë falas)
bashkë me biçikletën?	Tarifë e plotë e klasës së 2-të (çmim i reduktuar për posedues të abonimeve "Libero", "Halbtax" ose "General" (për kuptimin shih lart) si dhe fëmijë nën 16 vjeç); transportimi vetëm në rast të ofertës së mjaftueshme të vendeve
tashmë një General-Abo (posedues i një abonimi të përgjithshëm)?	Nuk ka nevojë për një biletë tjetër

A jeni ju ...**Abonim ideal/biletë ideale**

një grua që nga 64 vjeç respektivisht një burrë që nga 65 vjeç?

Libero-Abo Senior (abonim Libero për femra që nga ditëlindja e 64-t dhe për meshkuj që nga ditëlindja e 65-të) për çmimin e reduktuar (vetëm klasa e 2-të)

një nxënës/e, nxënës/e profesioni ose student/e midis 16 dhe 25 vjeç?

Libero-Abo Junior (abonim Libero për të rinjtë deri në ditëlindjen e 25-të) për çmimin e reduktuar (vetëm klasa e 2-të)

Këshillimi dhe blerja: Këshillim të plotë merrni në qendrën e informacionit BERNMOBIL, Bärenplatz 8 (hyrja UBS). Të hënën deri të premten nga ora 08.30 deri në orën 18.00, Biletat Libero dhe plane të udhëtimeve ka në dyqanin Libero-Shop, Bubenbergplatz 5. Të hënën deri të premten ora 08.00-19.00, të shtunën ora 08.00-17.00, të dielën i mbyllur. Në dyqanin Libero mund të hyni me karrige me rrota. Informacione dhe oferta për udhëtimin pa pengesa ju gjeni në dyqan ose këtu: www.bernmobil.ch > [Kundenservice](#) > [Hindernisfrei unterwegs](#).

Kursi i lëvizshmërisë të jesh & mbetesh mobil: Këto kurse u drejtohen të gjithëve, të cilët e shmangin automatit e biletave, kanë probleme me orientimin në stacionin e trenit, e ndjejnë vetveten të pasigurt në rrugët dhe, dhe, dhe... ose të gjithë njerëzve të interesuar dhe kureshtarë / por në plan të parë njerëzve mbi 50 vjeç. www.mobilsein-mobilbleiben.ch.